

## **BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SHA**

### **VENDIM TEKNIK Nr. 2-C**

**Për**

**“Kompetencën profesionale e Agjentit Klerues të Certifikuar”**

Në mbështetje të dispozitave të;

- I. Seksionit C.2.5, Kapitulli C të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes për transaksionet në Tregjet e ALPEX-it.

#### **ALPEX SHA Miratoi:**

1. Procedurën e certifikimit të Agjentëve Klerues, për pjesmarrjen në Klerimin e Transakioneve në Tregjet e ALPEX.
2. Vendim Teknik Nr.2-C i paraqitet për njoftim Entit Rregullator të Energjisë – ERE / Zyrës së Rregullatorit për Energji - ZRrE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ADMINISTRATOR I ALPEX SHA**

**Sokol Dishnica**

## VENDIM TEKNIK Nr. 2-C

### NENI 1

#### 1. QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI

- (a) Qëllimi i këtij Vendimi Teknik është të përcaktojë kërkesat e kompetencës profesionale që duhet të përmbushet nga punonjësit dhe drejtuesit e Anëtarëve të Klerimit të ALPEX si dhe procedurat për certifikimin e tyre si Agjent Klerues i Certifikuar, për qasjen e tyre në Sistemin e Klerimit të Tregut të Energjisë të ALPEX (në vijim referuar si "EMCS") në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes dhe Vendimet Teknike të Klerimit.
- (b) Ky Vendim Teknik zbatohet për Anëtarët e Klerimit dhe për ata persona që mbajnë pozicionin e Agjentit Klerues të Certifikuar tek një Anëtar Klerimi.
- (c) Kushtet dhe përkufizimet e përdorura në këtë Vendim Teknik do të kenë të njëjtin kuptim si ato të përcaktuara në Përkufizimet e rregullave të tregut të energjisë elektrike, në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes, si dhe të çdo Vendimi Teknik të nxjerrë për zbatimin e tyre, përveç nëse parashikohet shprehimisht ndryshe.

Në çdo rast, dispozitat e këtij Vendimi Teknik interpretohen në përputhje me rregullat dhe parimet e parashikuara në Fushëveprimin e Zbatimit të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.

### NENI 2

#### 2. PROCESI I CERTIFIKIMIT TË PUNONJËSVE TË ANËTARËVE TË KLERIMIT

##### 2.1. Certifikimi i Agjentit Klerues të Certifikuar

- (a) Me qëllim të njohjes së kompetencës profesionale të punonjësve të Anëtarit të Klerimit, duhet të lëshohet Certifikata për Agjentin Klerues (në vijim referuar si "CAK").
- (b) CAK lidhet me kryerjen e detyrave të një Agjenti Klerues të Certifikuar për një Anëtar Klerimi të ALPEX për Klerimin e Transaksioneve në Tregjet e ALPEX-it.

##### 2.2. Detyrimet e Anëtarëve të Klerimit

- (a) Anëtarët e Klerimit duhet të sigurohen që Agjenti Klerues i Certifikuar i punësuar prej tyre, të ketë një CAK.
- (b) Anëtarët e Klerimit duhet të sigurohen gjithashtu që Agjenti Klerues i Certifikuar i punësuar prej tyre, të ketë në mënyrë të vazhdueshme, njohuri të mjaftueshme të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes

dhe procedurave në përgjithësi të cilat qeverisin funksionimin e ALPEX dhe sistemeve të tij.

### 2.3. Parakushtet për dhënien e **CAK**-së

- (a) **CAK** jepet nga ALPEX me kusht që të përmbushen të gjitha kërkesat e mëposhtme:
- (i) kandidati duhet të përcaktohet nga Anëtari i Klerimit, nëpërmjet një kërkesë me shkrim tek ALPEX;
  - (ii) kandidati duhet të jetë mbi 18 vjeç;
  - (iii) kandidati ka marrë pjesë në trajnimet përkatëse dhe ka kaluar provimet e zhvilluara për dhënien e Certifikatës përkatëse në përputhje me dispozitat e paragrafëve 3.1 deri në 3.4 të nenit 3 të këtij Vendimi Teknik;
  - (iv) kandidati i ka paguar tarifat përkatëse ndaj ALPEX-it në përputhje me dispozitat e paragrafit 3.5, nenit të 3 të këtij Vendimi Teknik dhe Listës së tarifave të ALPEX;
  - (v) nuk është dënuar - sipas paragrafit 2.3 (b);
- (b) **CAK** nuk jepet nëse:
- (i) kandidati është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra që përbëjnë pengesë për emërimin e tij ose të saj në një funksion të nëpunësit civil, ose është shkarkuar nga një pozicion tjetër për arsye disiplinore bazuar në të njëjtin ligj, ose është dënuar me gjykim të formës së prerë për ndonjë veprë të parashikuar në Kodin Penal siç ishin në fuqi (mos përmbushje dhe mashtrim për transaksione financiare) dhe legjisllacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
  - (ii) një gjobë për shkelje të dispozitave të shembullit (i) më sipër, për të cilën koha e lejuar për paraqitjen e një apeli gjyqësor ka skaduar ose në lidhje me të cilën është bërë një gjykim përfundimtar duke hedhur poshtë apelin.
  - (iii) referimet ndaj dispozitave të mësipërme përfshijnë edhe versionet e mëparshme të tyre në varësi të kohës kur është kryer vepra penale.

### 2.4. Aplikimi dhe Dokumentacioni për Certifikim

- (a) Aplikimi për marrjen e **CAK**-së dorëzohet pranë ALPEX-it, i cili siguron lëshimin e **CAK**-së në përputhje me kushtet e këtij Vendimi Teknik.
- (b) Aplikimi duhet të dorëzohet, i plotësuar dhe i nënshkruar, sipas formularit tip i cili vihet në dispozicion nga ALPEX-i në faqen zyrtare të internetit.

- (c) Aplikimi duhet të shoqërohet nga dokumentet mbështetëse të kërkuara;
  - (i) Një dokument identifikimi të vlefshëm të kandidatit,
  - (ii) Dëshmia nga gjykata dhe prokuroria përsa i përket statusit të kandidatit për precedentë penalë, të lëshuara jo më vonë se 30 ditë,
  - (iii) Mandatin e pagesës së tarifave të aplikueshme, siç janë specifikuar në seksionin 3.5, neni 3 të këtij Vendimi Teknik.
- (d) Me qëllim që të shqyrtohet nga ALPEX-i, aplikimi dhe dokumentacioni përkatës duhet të jetë i plotë dhe i qartë përpara se të dorëzohen brenda afatit të përcaktuar, atyre të 5 (pesë) ditëve pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Kuadër për Klerim.

### NENI 3

## 3. TERMAT DHE KUSHTET PËR KRYERJEN E SEMINAREVE DHE PROVIMEVE

### 3.1. Përgjegjësia për kryerjen e seminareve dhe provimeve

- (a) Seminaret dhe provimet për dhënien e **CAK**-së mbahen nga ALPEX-i nën mbikëqyrjen e Komisionit të Provimit të seksionit 3.2.
- (b) Me qëllim të kryerjes së seminareve të certifikimit dhe provimeve për dhënien e **CAK**-së, Komisioni i Provimeve duhet së pari të miratojë, programin e trajnimit duke përfshirë programet e studimit dhe materialin e provimit, në përputhje me seksionin 3.3, si dhe lektorët.
- (c) Vendi dhe koha për mbajtjen e seminareve dhe provimeve të certifikimit për dhënien e **CAK**-së, si dhe të gjitha çështjet e tjera të lidhura me të, do të publikohen në faqen zyrtare të internetit të ALPEX-it.

### 3.2. Komisioni i Provimit

- (a) Komisioni i Provimit mbikëqyr mbarëvajtjen e provimeve të certifikimit në përputhje me dispozitat e këtij neni.
- (b) Komisioni i Provimit do të jetë gjithashtu përgjegjës për kontrollimin e kushteve për tërheqjen ose revokimin e certifikatës në përputhje me seksionin 3.6, si dhe për çdo çështje tjetër që lidhet me lëshimin e një **CAK** sipas këtij neni.
- (c) Anëtarët e Komisionit të Provimit do të jenë pjesë e personelit të ALPEX-it.

### 3.3. Materiali për studim

- (a) Materiali për studim në lidhje me provimet për dhënien e **CAK**-së mbulon temat që kanë të bëjnë me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes, në përputhje me dispozitat

rregulluese që qeverisin Klerimin dhe Shlyerjen, siç specifikohet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes të Tregjeve të ALPEX-it si dhe EMCS-në dhe procedurat e aplikuara.

- (d) Gjuha e materialit të studimit dhe e provimit do të jetë në gjuhën shqipe dhe/ose angleze, sipas kërkesës.

### **3.4. Provimi**

- (a) Tarifa e provimit duhet të paguhet përpara hyrjes në provimin për Certifikim.
- (b) Provimet e Certifikimit përpilohen sipas metodologjisë të përcaktuar nga ALPEX.
- (c) Komisioni i Provimit do të vendosë për çdo çështje përpara zhvillimit të provimit.
- (d) Komisioni i Provimit duhet të përgatisin pyetjet, të mbikëqyrin procesin e provimit, të vlerësojnë dhe firmosin fletën e përgjigjeve të çdo provimi dhe të hartojnë listën përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm. Për të kaluar provimin, kandidatët duhet t'u përgjigjen saktë të paktën gjashtëdhjetë për qind (60%) të pyetjeve.
- (e) Provimi mund të kryhet fizikisht ose online, sipas rastit. Data dhe ora e provimit do të publikohen në faqen zyrtare të internetit të ALPEX-it.

### **3.5. Tarifat Fikse të pagueshme për ALPEX**

Në mënyrë që të merret në konsideratë aplikimi për **CAK**, kandidatët duhet t'i paguajnë ALPEX-it tarifën e aplikueshme, sipas Listës së Tarifave të ALPEX-it e publikuar në faqen zyrtare të internetit të ALPEX-it.

### **3.6. Pezullimi i një CAK**

Një **CAK** është lëshuar në përputhje me kushtet e këtushme dhe do të revokohet përkohësisht ose do të pezullohet nga ALPEX:

- (a) Nëse veprimet e Agjentit Klerues të Certifikuar janë në shkelje të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes nga mbajtësi i **CAK**-së.
- (b) Nëse informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur për dhënien e **CAK**-së janë të rremë ose ka mashtruar.
- (c) Nëse Agjenti Klerues i Certifikuar është dënuar ose gjobitur në përputhje me dispozitat e nën seksionit 2.3(b).

## **NENI 4**

#### **4. HYRJA NË FUQI**

Ky Vendim Teknik hyn në fuqi që nga data 07/09/2023.

Ky Vendim Teknik do të publikohet në faqen zyrtare të internetit [www.alpex.al](http://www.alpex.al)